



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:013367
 Datë: 28.02.2022
 Numri i dosjes: 2021:013368

C.nr.102/21

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Burim Emërllahu, në çështjen kontestuese të paditëses V.A nga Fshati ..., rruga ‘...’, Komuna e Ferizajit , me numër personal të letërnjoftimit ... të lëshuar nga MPB-ja, të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson Jur.Mentor Avdiu Zyrtar Ligjor në Federatën e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës për Regjionin e Ferizajit me adresë në rrugën ‘Reçaku’ objekti i QMF-1 ,kati II, nr.14 në Ferizaj, kundër të paditurës Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës –Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj me adresë në rrugën ‘Ramadan Rexhepi’ në Ferizaj, baza juridike :shpërblim jubilar, me datë 28.02.2022 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses V.A ,dhe **DETYROHET** e paditura Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës –Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj që paditëses V.A në emër të shpërblimit jubilar-një pagë jubilarë të ia paguaj shumën prej 652.92 euro, me kamatë prej 8 % në vit ,duke llogaritur nga data e ushtrimit të padisë 26.01.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Detyrohet e paditura Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës-Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj ,që paditëses V.A ,në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore –taksës gjyqësore për padi t’ia paguaj shumën prej 20 euro , në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja V.A ,ka parashtruar padi në këtë Gjykatë, kundër të paditurës Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës-Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj , për shpërblimin jubilar –një pagë jubilarë .

Nga thëniet e paditëses në padi rezulton se e njëjta padinë e bazon në faktin se është në marrëdhënie pune te e paditura e përcaktuar në vendin e punës ,infermiere e përgjithshme ku vazhdon tutje në këtë pozitë.E paditura edhe përkundër faktit se ka pranuar kërkesë nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës për implementimin dhe zbatimin e Kontratës Kolektive Sektoriale ,respektivisht neni 17 i kësaj kontrate nuk i është përgjigjur duke mos përmbushur obligimet që dalin nga kjo marrëveshje.Paditësja deri në momentin e parashtrimit të kësaj kërkesëpadie ka mbi 10 vite përvojë të punës ,me që rast plotëson kriteret e parapara me nenin 17 të KKS-së për përfitimin e shpërblimeve jubilarë respektivisht përfitimin e një page në vlerë të pagës të realizuar në muajt e fundit.Kërkesa e paditëses parashtrohet konform dispozitave të Kontratës Kolektive Sektoriale ,Nr.05-3815 të lidhur mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës për një pagë mujore në emër të shpërblimit jubilar 1x652.92 euro ,të bazuara në nenin 17 par.3 dhe 4 .Andaj edhe paditësja ka parashtruar këtë padi në këtë gjykatë.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit Jur.Mentor Avdiu-Zyrtar Ligjor në Federatën e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës për regjionin e Ferizajit ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia me përmbajtje si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

I padituri Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitarë i Kosovës-Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi të gjitha theksimet e palës paditëse në padi.Paditësja V.A është në marrëdhënie pune në SPF,infermiere në Laborator e cila i është drejtuar gjykatës për realizimin e një page jubilarë. Sipas tyre kërkesëpadia është e pa bazuar përkundër marrëveshjes Kolektive,SHSKUK-ja nuk ka ndarë fonde të veçanta për pagesat jubilarë,çka që Spitali i Përgjithshëm nuk ka mjete për pagesat jubilarë sipas nenit 52 të MPK dhe si e tillë aktualisht është e pa realizueshme nga Spitali i Përgjithshëm Ferizaj.Andaj kanë kërkuar nga gjykata që të refuzohet kërkesëpadia e paditëses V.A si dhe të vërtetohet se Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj nuk ka bërë as një lëshim procedural,ligjor dhe faktik.

Me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje civile juridike janë administruar si provë: vërtetimi i datës 14.12.2020 i lëshuar nga i padituri,kërkesa e datës 01.04.2019 nr.289 drejtuar të paditurit nga Sindikata e Pavarur e Shëndetësisë ,kërkesa e datës 23.04.2019, përgjigja e datës 12.04.2019 me numër 261/5,lista e pagave në emër të paditëses ,kontrata e punës në emër të paditëses të dt.31.07.2015.

Gjykata provat e administruara i ka vlerësuar sipas nenit 8 të LPK-së dhe ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Me leximin e vërtetimit i datës 14.12.2020 me të cilën vërtetohet se V.A me numër personal ... është në marrëdhënie pune në Spitalin e Përgjithshëm të Ferizajit nga data 01.05.2010 ku vazhdon tutje në pozitën si infermiere.

Me leximin e kërkesës së dates 01.04.2019 me numër 289 gjykata ka vërtetuar se Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës ka parashtruar kërkesë për pagesën e shpërblimeve jubilarë.Kjo kërkesë mbështetet në nenin 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës dhe nenin 17 paragrafi 3 dhe 4 I Kontratës Kolektive Sektoriale.Për 10 vjet të përvojës ë punë në institucione shëndetësore ,në vlerë të një pagave mujore të tij,për 20 vjet të përvojës në punë në institucone shëndetësore,në vlerë të dy page mujore të tij si dhe për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore ,në vlerë të tri pagave mujore të tij.Andaj sipas kësaj kërkesë të FSSHK-së kush do që i plotëson këto kriterë dhe janë anëtarë të FSSHK-së të shpërblehen konform dispozitave të Kontratës Kolektive Sektoriale.

Me leximin e kontratës së punës e datës 31.07.2015 ,gjykata ka vërtetuar se Spitali Rajonal – Ferizaj të cilën e përfaqëson Dr.Bejtush Jaha-Drejtor Ekzekutiv i Spitalit Rajonal të Ferizajit ka lidhë kontratë pune me Znj.V.D me numër personal ...e cila me profesion është llaborante me adresë në Dardani-Ferizaj,duke filluar nga data 31.07.2015 deri në afat të pa caktuar.

Me leximin e përgjigjes së datës 12.04.2019 me nr..261/5 gjykata ka vërtetuar se Ministria e Shëndetësisë –Departamenti Ligjor jep sqarim se :Kontrata Kolektive Sektoriale e bazuar në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 rregullon marrëdhëniet e punës ,të drejtat dhe detyrimet në mes të punësuarit dhe punëdhënësit në të tri nivelet e sistemit shëndetësor.Përmes KKS-së zgjerohen të drejtat nga marrëdhënia e punës bazuar në legjislacionin në fuqi dhe përfitues të beneficioneve të cilat dalin nga kjo marrëveshje.

Me leximin e listës së pagave ,gjykata ka vërtetuar se vlera e pages bruto e V.A është 652.92 euro kurse vlera e pages neto është 571.77 euro dhe e njejta ka përvojë pune 10 vite.

Ndërmjet palëve nuk ishte kontestues fakti se e paditësja është punëtore e të paditurës,nuk ishte kontestues fakti se i padituri nuk ia ka paguar paditëses një pagë jubilarë e që një gjë të tillë e ka pranuar edhe i padituri sepse edhe i padituri në përgjigje në padi ka theksuar se nuk janë ndarë fonde të mjaftueshme për pagesat jubilarë edhe si pasojë e kësaj edhe nuk i është paguar paguar paga jubilarë.

Me nenin 17 paragrafi 3 pika 1.1 të Kontratës Kolektive Sektoriale të lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës në fuqi nga data 11.06.2018 është paraparë: Punëtorët Shëndetësorë në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi fundit për 10 vjetë të përvojës në punë në institucionet shëndetësore ,te punëdhënësi fundit në vlerë të një page mujore të tyre.

Kjo gjykatë duke u nisur nga dispozitat e sipër përmendura të Kontratës Kolektive Sektoriale, si dhe gjendjes faktike të shpjeguar më lartë ,ka nxjerrur përfundim se është e bazuar kërkespacia e paditëses dhe nga kjo arsye edhe e ka detyruar te paditurën që paditëses t’ia paguaj shumën si në pikën I të dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Theksimi i të paditurës se nuk ka mjete financiare nuk e liron nga obligimi për të përmbushur detyrimet kontraktuese ,sepse baza ligjore e kërkesëpadisë së paditësit qëndron edhe në Ligjin për Mardhëniet e Detyrimeve, dispozitat përkatëse të këtij ligji që e rregullojnë materien e qështjes së kontratës,kurse konform nenit 8 të Ligjit për Mardhënjeve të Detyrimeve Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit.

Kurse me nenin 245 paragrafi 1 të LMD-së është paraparë Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.

Vendimi për kamatën është bazuar në nenin 382 të LMD-së së Kosovës.

Vendimi për shpenzimet e procedurës kontestimore është bazuar në nenin 452.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Gjyqtari

Burim Emërllahu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.